S.E.R.E.
Singapore Europe Real Estate

S.E.R.E SHPK

Pasqyrat Financiare per Vitin ushtrimor 2015

INDIVIDUALE

SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE sh.p.k.
NIPT. L22022002F
TIRANE - ALBANIA

Permbajtja

1. PASQYRA E SITUATES FINANCIARE 1
2. PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE 3
3. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE 4
4. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL 5
5. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME 6
6. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANICIARE 6
7. GJYKIMET, VLERESIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME 6
8. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL 6
9. MJETE MONETARE 11
10. KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME 11
11. PARAPAGESA PER FURNIZIME 11
12. AKSIONE DHE INVESTIME TE TJERA NE PJESEMARRJE 11
13. KERKESA TE ARKETUESHME AFATGJATA 12
14. TOKA 12
15. AKTIVE TE TJERA AFATGJATA (NE PROCES) 12
16. DETYRIME TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE 12
17. DETYRIME TE PAGUESHME NDAJ PUNONJESVE 13
18. DETYRIME TE PAGUESHME NDAJ TATIMEVE 13
19. HUA TE TJERA AFATGJATA 13
20. SHPENZIMET 13
21. TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE 14
22. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT 14

S.E.R.E
PASQYRA FINANCIARE VITI 2015
(Vlerat ne ALL)

1. PASQYRA E SITUATES FINANCIARE

A	AKTIVET	Shenime	Viti Ushtrimor 2015	Viti Ushtrimor 2014
I	**Aktivet Afatshkurtra**			
1	**Mjete monetare**	9	**18,375,277**	**73,414,114**
2	**Dervativë dhe aktive financiare të mbajtura për tregtim**			
a)	Derivativët			
b)	Aktivet e mbajtura për tregtim			
	Totali		**18,375,277**	**73,414,114**
3	**Aktive të tjera financiare afatshkurtra**			
a)	Llogari / Kërkesa te arkëtueshme		0	0
b)	Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	10	**342,524**	**65,198**
c)	Instrumente të tjera borxhi			
d)	Investime të tjera financiare			
	Totali		**342,524**	**65,198**
4	**Inventari**			
a)	Lëndët e para			
b)	Prodhim në proces		23,670,533	
c)	Produkte të gatshme			
d)	Mallra per rishitje			
e)	Parapagesa për furnizime	11	11,819,816	5,722,069
	Totali		35,490,349	**5,722,069**
5	**Aktivet biologjike afatshkurtra**			
6	**Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje**			
7	**Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra**		**0**	**0**
	AKTIVET TOTALE AFATSHKURTRA		**54,208,150**	**79,201,381**
II	**Aktivet Afatgjata**			
1	**Investimet financiare afatgjata**			
a)	Aksione dhe pjesmarrje të tjera në njësi te kontrolluara (vetëm për pasqyrat financiare të pakonsoliduara)			
b)	Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje	12	675,000	675,000
c)	Aksione dhe letra të tjera me vlerë			
d)	Llogari / Kërkesa te arkëtueshme afatgjata	13	83,620,000	16,230,500
	Totali		***84,295,000***	***16,905,500***
2	**Aktive afatgjata materiale**			
a)	Toka	14		82,620,000
b)	Ndertesa (minus amortizimi)			
c)	Makineri dhe paisje (minus amortizmi)			
d)	Aktive të tjera afatgjata materiale (me vlere kontabel te mbetur)			
	Totali			***82,620,000***
3	**Aktive biologjike afatgjata**			
4	**Aktivet afatgjata jomateriale**			
a)	Emri i mirë			
b)	Shpenzimet e zhvillimit		0	0
c)	Aktive të tjera afatgjata jomateriale			
	Totali		*0*	*0*
5	**Kapitali aksionar i papaguar**		**0**	**0**
6	**Aktive të tjera afatgjata (në proces)**	15		**120,000**
	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		**84,295,000**	**99,645,500**
	TOTALI AKTIVEVE		**138,503,150**	**178,846,881**

SINGAPORE EUROPEAN ESTATE sh.p.k. NIPT: L22022002F TIRANE - ALBANIA

S.E.R.E
PASQYRA FINANCIARE VITI 2015
(Vlerat ne ALL)

B	PASIVET DHE KAPITALI	Shenime	Viti Ushtrimor 2015	Viti Ushtrimor 2014
I	**Pasivet Afatshkurtra**			
1	**Dervativët**			
2	**Huamarrjet**		0	0
a)	Huat dhe obligacionet afatshkurtra			
b)	Kthimet / ripagesat e huave afatgjata			
c)	Bono të konvertueshme			
	Totali		0	0
3	**Huat dhe parapagimet**			
a)	Te pagueshme ndaj furnitorëve	16	275,987	156,987
b)	Te pagueshme ndaj punonjësve	17	1,098,696	797,256
c)	Detyrimet tatimore	18	13,095	54,794
d)	Hua të tjera		1,000,000	
e)	Parapagimet e arkëtuara			
	Totali		*2,387,778*	*1,009,037*
4	**Grandet dhe të ardhurat e shtyra**			
5	**Provizionet afatshkurtra**			
	TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA		**2,387,778**	**1,009,037**
II	**Pasivet Afatgjata**			
1	**Huat afatgjata**			
a)	Hua , bono dhe detyrime nga qeraja financiare			
b)	Bonot e konvertueshme			
	Totali			*0*
2	**Huamarrje të tjera afatgjata**	19	**129,028,296**	**169,019,812**
3	**Provizionet afatgjata**			
4	**Grandet dhe të ardhurat të shtyra**			
	TOTALI I PASIVEVE AFATGJATA		**129,028,296**	**169,019,812**
	TOTALI I PASIVEVE		**130,416,074**	**170,028,849**
III	**Kapitali**			
1	**Aksionet e pakicës (vetem per pasq.fin.të kosoliduara)**			
2	**Kapitali që i përket aksionerëve të shoqërise mëmë (përdoret vetem per pasq.fin.të kosoliduara)**			
3	**Kapitali aksionar**	1	**14,111,000**	**14,111,000**
4	**Primi i aksionit**			
5	**Njësite ose aksionet e thesarit (negative)**			
6	**Rezerva statusore**			
7	**Rezerva ligjore**			
8	**Rezerva të tjera**			
9	**Fitimet e pashpërndara**		**(5,292,969)**	**(2,264,966)**
10	**Fitimi (humbja) e vitit financiar**		**(1,730,955)**	**(3,028,003)**
	TOTALI I KAPITALIT		**7,087,076**	**8,818,031**
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		**138,503,150**	**178,846,880**

SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE sh.p.k. NIPT: L22022005J TIRANE - ALBANIA

2. PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE

N.r.	P Ë R SH K R I M I	Shenime	Viti Ushtrimor 2014	Viti Ushtrimor 2014
1	Shitjet neto		**0**	**0**
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë shfrytëzimit			
3	Ndryshimet në inventarin e p.gatshme dhe p. proces			
4	Puna e kryer nga njësia ekonomike raportuese për qëllimet e veta dhe e kapitalizuar			
5	Mallra , lëndët e para dhe shërbimet		0	0
6	Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	**20**	**(2,351,449)**	**(963,560)**
7	Shpenzime të personelit		**(1,684,371)**	**(1,189,893**
a)	Pagat		(1,460,352)	(1,069,236)
b)	Shpenzimet e sigurimeve shoqërore		(224,019)	(120,657)
c)	Shpenzimet për pensionet			
8	Rënia në vlerë (zhvlerësimi) dhe amortizimi			
	Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit		**(4,035,820)**	**(2,153,453)**
1	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësite e kontrolluara			
2	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesmarrjet			
3	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	**21**	**2,304,865**	**(874,550)**
a)	*Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata*			
b)	*Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi*		1,557	328,977
c)	*Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit*		2,303,308	(1,203,528)
d)	*Të ardhurat dhe shpenzime të tjera financiare*		-	-
	Fitimi (humbja) para tatimit		**(1,730,955)**	**(3,028,003)**
	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 15 %			
	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		**(1,730,955)**	**(3,028,003)**

SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE sh.p.k. NIPT: L22022002F TIRANE - ALBANIA

Emri/Firma

Administratori

SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE sh.p.k. NIPT: L22022002F TIRANE - ALBANIA

3. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE[1]

Sipas metodës indirekte				ne leke
N.r.	**P Ë R SH K R I M I**	**Shenime**	**Viti Ushtrimor 2015**	**Viti Ushtrimor 2014**
A	**Fluksi parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit**			
1	Fitimi para tatimit		(1,730,955)	(3,028,003)
	Rregullimet për :			
2	Amortizimin			
3	Humbjet (fitimet) nga këmbimet valutore			
4	Të ardhura nga investimet			
5	Të ardhura nga interesat			
6	Shpenzime për interesa			
7	Rritje / rënie në tepricën e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera		(72,664,753)	(88,462,068)
8	Rritje / rënie ne tepricën inventarit		(23,670,533)	
9	Rritje / rënie në tepricën detyrimeve, për t`u paguar nga aktiviteti		(39,612,775)	
10	Paratë e perftuara nga aktivitetet			
	Paraja nga aktivitetet e shfrytezimit		**(137,658,836)**	**(91,490,072)**
	Interesi i paguar			
	Tatim fitimi i paguar			
	Paraja neto nga aktivitetet e shfrytezimit		**(137,658,836)**	**(91,490,072)**
B	**Fluksi i parave nga veprimtarite e investuese - Cash flows from investing activities**			
1	Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara			
2	Blerja e aktiveve afatgjata materiale		-	-
3	Të ardhura nga shitja e paisjeve		82,620,000	
4	Interesi i arkëtuar			
5	Dividendët e arkëtuar			
	Paraja neto, e perdorur ne aktivitetet e investuese		82,620,000	-
C	**Fluksi i parave nga veprimtarite e financiare**			
1	Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		-	-
2	Te ardhura nga huamarrje afatgjata		-	9,215
3	Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		-	-
4	Dividendë të paguar			
	Para neto e perdorur ne aktivitetet financiare		-	-
	Rritja / renia neto e mjeteve monetare		(55,038,836)	(91,480,857)
	Mjete monetare ne fillim te periudhes kontabel		73,414,114	164,894,971
	Mjete monetare ne fund te periudhes kontabel		**18,375,278**	**73,414,114**

SINGAPORE EUROPEAN REAL ESTATE sh.p.k. NIPT: L22022002F TIRANE - ALBANIA

[1] Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare është përgatitur sipas metodës indirekte.

4. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione të thesarit	Rezerva statusore dhe ligjore	Fitim i pashpërndarë	Totali i Kapitaleve të veta
Pozicioni më 31 Dhjetor 2014	**14,111,000**				**(5,292,969)**	**8,818,031**
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						**0**
Pozicioni i rregulluar						**0**
Fitimi neto i vitit financiar					(1,730,955)	**(1,730,955)**
Rritje e rezervës kapitalit						**0**
Emetimi i aksioneve	0					**0**
Dividendët e paguar						**0**
Pozicioni më 31 Dhjetor 2015	**14,111,000**				**(7,023,924)**	**7,087,076**

5. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME

"Singapor Europe Real Estate" sh.p.k (" Shoqeria") eshte krijuar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me date 08 Gusht 2012 ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me aksioner te shoqerise "Euro Singaporean Real Estate and Trade" L.T.D dhe Z. Denis Alimehmeti Kapitali i shoqerise ne daten 31.12.2014 eshte ne vleren 14,111,000 Leke te zoteruara nga ortaket e shoqerise me raportet si me poshte:

1. Singapore Europe Real Estate zoteron 80 % te kapitalit te shoqerise me vleren 11,288,800 Leke
2. Z. Denis Alimehmeti zoteron 20 % te kapitalit te shoqerise me vleren 2,822,200 Leke

Objekti: Aktiviteti i shoqerise eshte Investimi ne pasuri te paluajtshme
Certifikimi tatimor: NIPT L22022002F
Forma juridike e shoqerise: Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar
Adresa e selise : Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati nr.89, Shkalla A, Apartamenti nr.33, Kati 9,Tirane
Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne ambjente qe jane te mara me qira.
Numri i punonjesve me date 31 Dhjetor 2014 ka qene 2 punonjes

Administrator i shoqerise eshte Z. Klard Flaga

6. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANICIARE

Shoqeria i mban te dhenat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare të vitit 2014 në bazë të Standardeve Kombëtare të Raportimit Financiar ("SKK"), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 4292 datë 15.06.2006 dhe në përputhje me Ligjin mbi kontabilitetin no: 9228 datë 29 Prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.
Pasqyrat finaciare janë përgatitur në bazë të kostos historike.
Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("Lekë"), e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik, ku operon Shoqëria. Shifrat janë të rrumbullakosura në Lekë.
Aktivet financiare dhe detyrimet financiare janë të kompensuara dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për t'i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përpjekje për t'i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompensuara në pasqyrën e te ardhurave gjithpërfshirëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard i kontabilitetit ose interpretim, dhe ndonjë politikë kontabël e Shoqërisë.

7. GJYKIMET, VLERESIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që Drejtimi të bëjë disa gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.
Vleresimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilen vlerësimi kryhet dhe në ndonjë periudhë të ardhshme, në të cilën ato ndikojnë. Informacioni mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë paraqitur më poshtë.

8. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Rregjistrimet kontabël të njësisë janë të përgatitura në Lekë Shqiptar, e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës se raportimit që është kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2014, 1 Euro me 140.14 Lekë dhe 1 USD me 115.23 Lekë.

Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të rregjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse si fitim apo humbje në periudhën në të cilën ata ndodhin përvec diferencave të këmbimeve për huamarrjet në monëdhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim për përdorim të ardhshëm, të cilat përfshihen në kostot e atyre aktiveve kur ato lidhen me një rregullim në koston e interesit të huamarrjeve në monëdhë të huaj.

(b) Instrumentat financiare

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç'rregjistron një aktiv financiar në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset nga këto aktive skadojnë, ose transferon të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave të aktivit financiar me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe rreziqet që lidhen me pronësinë e aktivit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara nga shoqëria paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare kompesohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto në vlere neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat financiar jo derivativë të shoqërisë përfshijnë të drejta të tregtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, detyrime të tregtueshme dhe të tjera

Mjetet monetare dhe ekujvalentet e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare, si dhe depozitat afatshkurtra me nje maturitet tre mujor ose me pak. Per qellime te pasqyres se flukseve monetare, mjetet monetare dhe equivalentet e tyre perbehen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra te percaktuara me lart, pasi i zbritet teprica e paradhënieve bankare.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi

Huamarrjet dhe parapagimet

Huatë e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interest efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë për llogaritjen e kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimive të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skonton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuara përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër..

Llogaritëe pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit

Te tjera

Instrumenta të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueshme, duke përdorur metodën e normës së interest efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.*Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

(c) Aktivet Afatgjata investimi

Aktive afatgjata investimi, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qeratë dhe / ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe përfitimet nga pronësia transferohen te shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivet aftagjata investimi maten me modelin e kostos. Aktivet afatgjata investimi, të cilat janë në proces ndërtimi të lidhura me projekte të reja me të cilat po merrët shoqëria, për ndërtimin e magazinave që do të jepen me qera ku përfshirja e shoqërisë në menaxhimin do të jetë minimale. Si e tillë, shoqëria po llogarit kostot direkte të ndodhura gjatë procesit të ndërtimit dhe sjelljes së aktivit në kushtet për tu dhënë me qera.

(d) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parasë të mbuluara nga blerjet në monëdhë të huaj të aktiveve aftagjata materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato rregjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivit afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot ne vijim

Kostot për zëvëndësimin e një pjese të aktivit afatagjatë material rregjistrohen me vlerën kontabël të aktivit në rast së është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera e kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

(e) Aktive afatgjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar.

Kostot ne vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

(f) Zhvleresimi

Aktivet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënien e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktivi të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse

(në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktivet e zhvlerësuara në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shuma përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

Aktivet jo financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuara skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme. Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivit ose e njësive të tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

(g) Perfitimet e punonjesve

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenziemve në momentin e ndodhjes.

Pensioni i detyrueshëm

Shoqëria, gjate aktivitetit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve për të kontribuar ne planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostot që ndodhin për këto plane i takojnë shoqërisë dhe ngarkohen në fitimin ose humbjen brenda vitit ushtrimor.

Leja e zakonshme e paguar

Shoqeria njeh si detyrim shumat e paskontuara të kostove të lidhura me lejen vjetore e cila pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën.

(h) Provigjonet

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi qe të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

(i) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

(j) Të ardhurat nga qeratë

Të ardhuart nga qeraja janë të ardhura të përfituara nga kontratat e qerasë, përvec të ardhurave të kushtëzuara të qerasë të cilat njihen kur përfitohen. Kostot fillestare direkte që ndodhin gjatë negocimit të një kontarate qeraje njihen si shpenzime në termat e qerasë me të njëjtat baza sit ë ardhuarat nga qeraja.

Përpjekjet për të nënshkruar një kontratë qeraje janë shpërndarë në mënyrë të barabartë përgjatë aftatit të kontratës së qerasë edhe nëse këto pagesa nuk bëhën në këto baza. Afati i qerasë është një periudhë e pa anullueshme qeraje së bashku me afate të tjera të mëtejshme për të cilat qeramarrësi ka opsionin për të vazhduar qeranë, kur, në fillim të qerasë drejtimi ka një siguri të arsyeshme që qeramarrësi do ta ushtrojë këtë opsion.

Shumat e marra nga qeramarrësi për përfundimin e qerasë ose kompesimin e përfundimit të saj njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse kur lind e drejta për ti marrë ato.

(k) Pagesat per qeranë financiare

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në menyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës

Depozitimet e qeramarrësit

Detyrimet e depozitimeve të qeramarrësit fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe maten më kosto të amortizueshme kur është materiale. Diferencat ndërmjet vlerës fillestare të drejtë dhe shumës nominale përfshihet si një komponent i të ardhurave nga kontrata e qerasë dhe njihen në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

(l) Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

(m) Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet kostos së aktivit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

(n) Taksat

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përvec rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhurat e ardhshme të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

(o) Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojne në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korrigjueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorrigjueshme.

9. MJETE MONETARE

Ne kete ze perfshihen mjetet monetare gjendje ne date 31.12.2014, ne llogarite rrjedhese prane bankave te nivelit te dyte. Per njohjen fillestare te ketyre elementeve si dhe per gjendjet, eshte perdorur politika kontabel e "vleres se drejte".

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Monedhe Vendase	5,087,883	329,970
Monedhe te huaj	13,287,394	73,084,144
Depozite		
Totali	**18,375,277**	**73,414,114**

10. KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME

Ne kete ze jane perfshire kerkesa te arketueshme nga Drejtoria e Pergjithshme Tatimore mbi TVSH e kredituar ne blerje. Gjendja e detajuar paraqitet si me poshte:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
TVSH kreditore	342,524	65,198
Total	**342,524**	**65,198**

11. PARAPAGESA PER FURNIZIME

Ne kete ze jane perfshire parapagimet e shoqerise per furnizime ten je periudhe te ardhshme.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Archea Associati	5,610,496	5,722,069
Bolles & Willson	4,824,019	
Xheko Construction	1,385,300	
Totali	**11,819,816**	**5,722,069**

12. AKSIONE DHE INVESTIME TE TJERA NE PJESEMARRJE

Shoqeria ka kryer investime ne blerjen e 50 % aksioneve te shoqerise Adriatic Yachting Marina, paraqitja e meposhteme paraqet pjesemarrjen ne vlere deri me date 31/12/2015.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Adriatich Yahting Marina	675,000	675,000
Totali	**675,000**	**675,000**

13. KERKESA TE ARKETUESHME AFATGJATA

Ne kete ze jane perfshire e drejta e arketimit per shitjen e nje pjese te tokes bazuar ne kontratat e shitjes. Kjo vlere do te arketohet plotesisht ne vitin 2015.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Geri Kuke	0	2,951,000
Green Coast	0	13,279,500
Renaldo Xheko	1,000,000	
Klajd Toska	82,620,000	
Totali	**83,620,000**	**16,230,500**

14. TOKA

Shoqeria ka kryer investime ne blerjen e nje toke ne Dhermi, Himare dhe Svernec e cila do te perdoret per investimet e ardheshme te shoqerise. Cmimi i tokes do te likujdohet ne vitin 2015.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Toka	0	82,620,000
Totali	**0**	**82,620,000**

15. AKTIVE TE TJERA AFATGJATA (NE PROCES TE SHPREHURA NE INVENTARE)

Ne kete ze eshte perfshire sherbimi i dhene per nje studim mjedisor dhe pagesa e takses se ndikimit ne infrastrukrure

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Geo-Sky	120,000	0
Takse Ndikimit ne Infrastrukture	23,550,530	
Totali	**23,670,530**	**0**

16. DETYRIME TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE

Ne kete ze jane perfshire detyrimet e pagueshme ndaj furnitoreve, te cilet ne njohjen fillestare jane vleresuar me kosto. Ne vijim te njohjes fillestare, huate dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur cdo diference midis kostos dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv. Të pagueshme ndaj furnitorëve me vlere 156,987 lekë përbëhet nga detyrimi qe shoqeria ka ndaj furnitoreve detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Edlira Hyseni	35,000	35,000
Sonila Bejtja	2,400	
Eva Blushi	49,750	49,750
Plus Comm	10,237	
Edlira Malaj	8,600	
Jorgji Zallemi	170,000	
Gjergji Gjika		17,072
Total	**275,987**	**101,822**

17. DETYRIME TE PAGUESHME NDAJ PUNONJESVE

Ne zerin te pagueshme ndaj punonjesve shuma 797,256 leke perfaqeson detyrimin e shoqerise ndaj administratorit per pagat e papaguara. Ky detyrim do te likujdohet ne vitin 2015.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Punonjes	1,098,696	797,256
Totali	**1,098,696**	**797,256**

18. DETYRIME TE PAGUESHME NDAJ TATIMEVE

Në postin detyrime tatimore, shuma 54,794 lekë, përfaqëson detyrimin e shoqërisë per pagesen e sigurimeve shoqerore & shendetsore, TAP dhe tatimin ne burim per qerane. Ky detyrim eshte paguar ne muajin Janar 2015, detajuar si me poshte.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Tatim mbi te ardhurat	1,025	11,652
Sig. shoqerore & shend	10,570	38,142
Tatim ne burim	1,500	5,000
Totali	**13,095**	**54,794**

19. HUA TE TJERA AFATGJATA

Ne vazhdim te njohjes fillestare, huate te tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur cdo diference midis kostos dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv. Në postin Huamarrje te tjera afatgjata, shuma 169,019,812 lekë përfaqëson kontributin e ortakut ne shoqëri dhe ndaj te treteve, per mbulimin e shpenzimeve operacionale dhe investimit, detyrimi do te kthehet ne momentin e zhvillimit te aktivitetit.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Ortaku	112,797,789	152,783,312
Detyrim per token	16,230,500	16,230,500
Totali	**129,028,296**	**169,019,812**

20. SHPENZIMET

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara te detajuara si me poshte. Shpenzimet e meposhteme te shoqerise jane ne funksion te aktivitetit te saj.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Shpenzime ligjore	14,133	220,360
Shpenzime per qerane	138,000	189,388
Shpenzime per kerkim dhe zhvillim	0	0
Shpenzime te tjera		472,512
Udhetime Dieta	2,077,303	
Shpenzime per telefoni	26,999	5,158
Shpenzime per komisione	57,893	39,022
Shpenzime per taksat vendore	37,120	37,120
Totali	**2,351,449**	**963,560**

21. TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Ne kete ze jane perfshire te ardhurat nga interesi i depozites dhe humbjet nga kembimet valutore.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Te ardhurat nga interesi	1,557	329,031
Shpenzime nga interesi		(53)
Humbje nga kembimet valutore	2,303,308	(1,203,528)
Shpenzime te tjera	-	-
Totali	**2,304,865**	**(874,550)**

22. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Pas datës së bilancit kontabël nuk ka ngjarje te ndodhura që kane ndikuar në rezultatin financiar të vitit ushtrimor.
Shoqeria pritet qe ne vitin 2016 te zhvilloje me tej aktivitetin e saj ne Investimin e pasurive te paluajtshme.